


REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga takimi me qytetarë mbajtur në fshatin Stroc, lidhur me dëgjimet buxhetore për vitin 2022-2024

Mbledhja u mbajt me datën 27.08.2021 me fillim në ora 17:00, në Shkollën "Liria".
Prezent nga zyrtarët e komunës:

1. z. Xhafer Tahiri- kryetar i komunës
2. z. Afrim Namani –nënkryetar i komunës etj.

Nga banorët e atij lokaliteti ishin të pranishëm 37 pjesëmarrës. Prej tyre 35 meshkuj dhe 2 femra.

Rend Dite

1. Dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2022-2024

Fjala hyrëse:

Kryetari i komunës zotëri Xhafer Tahiri fillimisht i njoftoj të pranishmit në pika të shkurtra lidhur me investimet e bëra gjatë këtyre viteve të udhëheqjes së tij me komunën, duke filluar me projektet infrastrukturore si shtrimin e rrugëve me asfalt, subvencionet e dhëna për fermerët, investimet në objektet edukativo-arsimore, ndërtimi i fushave sportive, rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtatit të lumenjve, rregullimin e shesheve në qytet, prurjen e ujit të pijes në pothuajse tërë territorin e komunës, menaxhimin e mbledhjes së mbeturinave, projekti pothuajse në mbarim për ndërtimin e zonës ekonomike, etj.

Pas përfundimit të fjalës hyrëse, u hap diskutimi:

1. Beqir Asllani, thekson si problem mungesën e kanalizimeve.
2. Lulëzim Klinaku, si bujk kërkon mbështetje edhe më të madhe.
3. Driton Murati, kërkon rregullimin e kanalizimit diku rreth 400 m, si dhe rregullimin e rrugës “Tafil Murati”.
4. Behar Haziri, kërkon ndriçimin e rrugëve të fshatit, thekson problemin dhe rrezikun nga qenët endacak, gjithashtu kërkon që rruga “Sejdi Haziri” të shtrohet me zhavorr.

Në fund u theksua se këto kërkesa do të shqyrtohen në ekzekutivin e komunës, komitetin për politikë dhe financa dhe rekomandohen për miratim në kuvendin e komunës për aprovim varësisht prej prioriteteve që do të përcaktohen si dhe varësisht prej disponueshmërisë buxhetore për investime kapitale për v. 2022-2024.

Procesmbajtës:

Premtim Maloku

